



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:045102  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05606863

KPPP.nr.1676/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kosova Asfalt” SH.P.K., me NUI:811052646, me seli në fshatin Gaçkë, Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arlina Haziria avokate në Prishtinë Rr.”Luan Haradinaj K1, nr.11-1, kundër debitorit “Toifor” Sh.P.K., me NUI:810484890, me seli në Prishtinë Rr.”Lidhja e Prizrenit” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 23.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Toifor” Sh.P.K., me NUI:810484890, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.10/22 i datës 18.01.2022 i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – fatura me numër 73 e datës 23.08.2018; fatura me numër 151 e datës 10.12.2018; fatura me numër 57 e datës 06.08.2019; fatura me numër 142 e datës 05.02.2019; fatura me numër 143 e datës 05.02.2019; fatura me numër 160 e datës 19.12.2019; fatura me numër 161 e datës 19.12.2019; fatura me numër 189 e datës 30.12.2019; fatura me numër 13 e datës 08.05.2020; fatura me numër 47 e datës 10.07.2020; fatura me numër 75 e datës 24.09.2020; fatura me numër 76 e datës 24.09.2020; fatura me numër 112 e datës 06.11.2020; fatura me numër 139 e datës 07.12.2020; fatura me numër 144 e datës 10.12.2020; fatura me numër 170 e

datës 26.12.2020; fatura me numër 109 e datës 09.11.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin e mbetur nga faturat e lartcekura në shumë prej 256,452.92 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga rënia në vonesë e deri në ditën e pagesës definitive, shpenzimet për përpilimin e propozimit në shumë prej 325.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaremit me dhunë, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbareme me qëllim të përmbijlljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorëve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbareme duke theksuar se fatura me numër 151 e datës 10.12.2018 dhe fatura me numër 73 e datës 23.08.2018, nuk i plotësojnë kushtet për përmbareme ngase janë të parashkruara, po ashtu fatura me numër 189 e datës 30.12.2019 dhe fatura me numër 170 e datës 26.12.2020, nuk përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbaremit për shkak se të njëjtat nuk janë të pranuar dhe të nënshkruara nga debitori. Tutje ka theksuar se të gjitha faturat tjera të bashkangjitura në propozim janë kopje dhe nuk janë të vërtetuara te noteri. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin dhe të anulohet urdhri për përmbareme dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës.

Kreditori, në afatin e paraprë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndër të tjerash ka theksuar se shkeljet e pretenduara në prapësim nuk ekzistojnë. Ka shtuar se kreditori me propozim ka bashkangjitur faturat origjinal të cilat edhe gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk qëndron pretendimi që fatura me me numër 151 e datës 10.12.2018 dhe fatura me numër 73 e datës 23.08.2018, janë parashkruar ngase për të njëjtat fatura debitori ka ndërprerë parashkrimin duke kryer pagesa të pjesshme. Tutje ka theksuar se janë përmbushë të gjitha kushtet ligjore për inicimin e procedurës përmbareme dhe se debitori pretendimet në prapësim nuk i ka mbështetur në asnjë provë. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pa themeltë, të mbetet në fuqi Urdhri për Përmbareme P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, si dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura me numër 73 e datës 23.08.2018; fatura me numër 151 e datës 10.12.2018; fatura me numër 57 e datës 06.08.2019; fatura me numër 142 e datës 05.02.2019; fatura me numër 143 e datës 05.02.2019; fatura me numër 160 e datës 19.12.2019; fatura me numër 161 e datës 19.12.2019; fatura me numër 189 e datës 30.12.2019; fatura me numër 13 e datës 08.05.2020; fatura me numër 47 e datës 10.07.2020; fatura me numër 75 e datës 24.09.2020; fatura me numër 76 e datës 24.09.2020; fatura me numër 112 e datës 06.11.2020; fatura me numër 139 e datës 07.12.2020; fatura me numër 144 e datës 10.12.2020; fatura me numër 170 e datës 26.12.2020; fatura me numër 109 e datës 09.11.2021, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas nenit 38 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi*

*i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”, ndërsa sipas nenit 40 par.1 nën par.1 të LPP-së përcaktohet 1. Propozimi për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:*  
*1.1. kërkesën përbarimore nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se fatura me numër 189 e datës 30.12.2019 dhe fatura me numër 170 e datës 26.12.2020, në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë as nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përbarueshmërisë.

Po ashtu fatura me numër 109 e datës 09.11.2021, fatura me numër 75 e datës 24.09.2020, fatura me numëra me numër 112 e datës 06.11.2020, fatura me numër 139 e datës 07.12.2020, fatura me numër 144 e datës 10.12.2020, fatura me numër 143 e datës 05.12.2019 dhe fatura me numër 142 e datës 05.12.2019, janë dorëzuar në kopje të pa vërtetuara, nga kjo rrjedh se urdhri përbarimor është nxjerr pa plotësimin e kushteve për lejimin e përbarimit ngase propozimi për përbarim bazohet në dokumente kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturën me numër 151 të datës 10.12.2018 dhe faturës me numër 73 të datës 23.08.2018 në shumën prej 133,936.77 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përbarim është paraqitur me datë 18.01.2022, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë.

Gjykata vlerësoj pretendimet e kreditorit lidhur me pranimin e faturave të lartcekura dhe disa pagesave të realizuara nga debitori mirëpo gjeti se fatura me numër 57 e datës 06.08.2019; fatura me numër 160 e datës 19.12.2019; fatura me numër 161 e datës 19.12.2019; fatura me numër 13 e datës 08.05.2020; fatura me numër 47 e datës 10.07.2020, përmbajnë nënshkrimin në faturë dhe janë dorëzuar në origjinal, por që vlera e përgjithshme e këtyre faturave të nënshkruara arrin shumën prej 150,526.82 €, ndërsa shuma e kërkuar sipas këtij urdhri është në shumën prej 256,542.92 €, ashtu që urdhri përbarimor është i paqartë dhe nuk precizohet pjesa e borxhit e cila është paguar dhe e cila kërkohet. Andaj kreditori nuk ka vepruar konform nenit 38 par.1 të LPP-së, për faktin se nuk dihet saktë kërkesa e kreditorit se për cilat fatura është precizuar borxhi si në propozim, e në këtë fazë të procedurës për gjykatën është e paqartë kërkesa e kreditorit dhe si e tillë përmban të meta sipas kësaj dispozite.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve në procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1676/22, datë 23.04.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.